



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR MEDIA DHE INFORMIM

Nr. 424 Prot.

Tiranë, më 29 . 05 2026

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
PËR AGJENCINË PËR MEDIA DHE INFORMIM
Periudha e raportimit : Janar – Prill 2026**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit nr. 14, datë, 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 4-mujore për vitin 2026.

Agjencia për Media dhe Informim, për vitin 2026 i është akorduar fondi buxhetor, sipas programit të miratuar, konkretisht:

1150 Shërbime të tjera

Programi konsiston në sigurimin dhe transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet si dhe qellimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore.

I. Realizimi i Produktit të Parashikuar për 4-mujorin e vitit 2026

Produkti i Agjencisë për Media dhe Informim është Komunikimi dhe Informimi Mediatik (Kodi 98704AN). Ky produkt ka një buxhet të planifikuar për 4 - mujorin në vlerën 53,255 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 42,498 mijë lekë, që përbën 80 % të planifikimit.

II. Përmbledhje e buxhetit të miratuar

(Në 000/Lekë)

Zëri buxhetor	Buxheti i miratuar	Buxheti i rishikuar	Plan Janar - Prill 2026	Fakti Janar – Prill 2026
Shpenzime Totale	154,463	154,463	53,255	42,498

Buxheti fillestar për vitin 2026, i planifikuar për këtë program, është 154,463 (në 000/Lekë).

Plani për periudhën Janar - Prill 2026 është 53,255 (në 000/Lekë).

Realizimi faktik për periudhën Janar – Prill 2026 është 42,498 (në 000/Lekë), që përbën 80% të planit 4 - mujor.

Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve të përgjithshme të Agjencisë për Media dhe Informim, dhe përmirësimin e infrastrukturës së saj.

III. Realizimi i shpenzimeve Janar – Prill 2026 për këtë program, sipas zërave kryesorë

(Në 000/Lekë)

Zëri buxhetor	Buxheti i miratuar	Buxheti i rishikuar	Buxheti i çelur 4-mujorit	Realizimi i 4 -mujorit	Përqindja e realizimit (%)
Paga	118,262	118,262	39,421	34,709	88 %
Sigurime Shoqërore	19,750	19,750	6,583	5,647	86 %

Mallra dhe shërbime të tjera	15,051	15,051	6,851	2,050	30 %
Transferta për buxhet Familjar dhe Individ	400	400	400	91	23 %
Investime	1,000	1,000	0	0	0
TOTALI	154,463	154,463	53,255	42,498	80 %

IV. Përshkrimi i Shpenzimeve dhe Produktit të Programit.

Buxheti për 4 – mujorin është realizuar në masën 80 % ndaj planit total.

Në analizën e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese, realizimi i fondeve buxhetore rezultojnë më i ulët krahasuar me planifikimin fillestar (plan-fakt). Mosrealizimi i plotë i fondeve buxhetore ka ardhur si rezultat i disa faktorëve objektivë, të cilët kanë ndikuar në ritmin e zbatimit të buxhetit.

Numri i punonjësve buxhetore të miratuar sipas planit vjetor është 69 dhe numri faktik është 67 nga ai i planifikuari.

1. Personeli: Realizimi në nivel 88 % për shkak të mosplotësisimit të strukturës.
2. Shpenzime për Sigurime Shoqërore: Realizimi në nivel 86 % për shkak të mosplotësisimit të strukturës.
- Nga institucioni janë bërë 2 procedura për plotësimin e vendeve vakante dhe nuk janë paraqitur kandidatë të cilët plotësonin kriteret e përcaktuara në shpalljet e publikuara. Për këtë arsye kemi mos plotësim të srrukturës.
3. Shpenzimet operative: Realizimi në nivel 30 % .

Në analizën e realizimit të shpenzimeve operative për periudhën raportuese konstatohet se nuk janë zhvilluar prokurime me vlerë të vogël si më poshtë :

- Blerje kancelari
- Materiale pastrami
- Blerje dokumentacioni

- Materiale per funksionimin e pajisjeve të zyrës
 - Materiale per funksionimin e pajisjeve special
 - Pjesë këmbimi goma bateri
 - Shpenzime për pritje dhe përcjellje
- Disa nga faktorët që ndikojnë në mos realizimin e prokurimeve janë.
- Administrimi i kujdesshëm i mallrave në magazine.
 - Numri i ulët i udhëtimeve të brendshme
 - Pamundësia për planifikimin e udhëtimeve të jashtme.
 - Mungesë aktivitetesh nga Drejtoria e Eventeve.

Në këtë zë buxhetor përfshihen shpenzime për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efektivitetit të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme (energji, uje, posta, karburant, telefon, etj.).

4. Trasferta për buxhet familjar dhe individual: Realizimi në nivel 23 % .

Në këtë zë buxhetor nuk është përdorur fondi i veçant i planifikuar në buxhet.

5. Investime: Realizimi është planifikuar në 4 - mujorin e dytë

Këto shpenzime janë të lidhura ngushtë me përmbushjen e detyrave të Agjencisë për Media dhe Informim dhe përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese të saj.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore nuk lidhet me mungesë planifikimi apo menaxhim joefektiv, por kryesisht me faktorë objektivë që kanë ndikuar në ritmin e zbatimit të buxhetit.

Megjithatë, institucioni ka marrë masa për përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të buxhetit me qëllim rritjen e nivelit të realizimit në periudhat në vijim.

V. Tregues me bazë gjinore

Numri i vajzave dhe grave në total është 45, të cilat përbëjnë 65 % të organikës, 5 janë në nivel drejtues.

Konkluzione:

Nga realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Prill 2026, mund të konkludohet se objektivi i politikës për menaxhimin efektiv të buxhetit dhe zbatimin e suksesshëm të programit është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**MANJOLA HASA**